VENDIM
Nr.169, datë 13.2.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA CUKALAT TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Cukalat të qarkut të Beratit, që do t'i transferohen në pronësi kësaj njësie.
2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 5 (pesë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Cukalat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

2. FORMULAR PER TRANSFERIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHTETERORE

(Mbeshtetur ne iventarizimin e pronave te veçanta te tipit kullota , livadhe, shkembore etj)

Institucioni I Pushtetit Qendror MMPAU

KomunaCukalat

Nr	Numri I pronave sipas VKM	Emertesa e Ekonomise Pyjore dhe kullosore (EPK)	Emertesa e ngastres Vendodhja sipas emertes popoullore	Numri ngastres	Destinacioni	Siperfaqa ne ha	Funksioni per te cilen perdoret prona	Institucioni Enti me pergjegjesite administrative	Institucioni Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera Shenime te Veçanta
1	44	Mali Bardhe	Shqopa e allambrezit	17.a	P Prodhues	34,46	Dru zjari	M.M.P.A.U	Komuna Cukalat	
2	45	Mali Bardhe	Shqopa e allambrezit	17.a	Rrepire	7,5	Kullote	M.M.P.A.U	Komuna Cukalat	
3	46	Mali Bardhe	Shqopa e allambrezit	17.a	Kullote polifite	25	Kullote	M.M.P.A.U	Komuna Cukalat	Eshte shpyllz vit 89
4	47	Mali Bardhe	Koria e Sinanajt	18.a	P prodhues	9	Dru zjari	M.M.P.A.U	Komuna Cukalat	Zbrit me V.KT vit 90 shfr 89
5	48	Mali Bardhe	Koria e Sinanajt	18.b	P prodhues	15,2	Dru zjari	M.M.P.A.U	Komuna Cukalat	Zbrit me V.KT vit 90 shfr 89

Njësia e Qeverisjes Vendore Komuna Cukalat

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
44 -48	Pyll+Sip te tjera	Në pronësi